

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bardhi: Kompania që u kap me 41 kilogramë kokainë, përfitojë nga Qeveria 1 milion euro nga fondet e I PARD
ADRESA	https://dosja.al/politike/bardhi-kompania-qe-u-kap-me-41-kilogramë-kokaine-perfitoje-nga-qeveria--i514704
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 18:27:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 18:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	34b9cef582f304c6a6e17453665e8edf01b6ef8891e34d8fd97aec2703723313
TEKSTI	68fbd52773c837f734599a4ec9d2f4237938ce3c5c0a4c4cd2c81b6efd4872e7
PAMJA	29f2810c0795fc917bddd3a2beb7ed8b79c3bffa258d27432ab0ffc520bc773cf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e104d688997769a4c8fb350cc7d87b2fc94620f7664446a1ec3648ab3cc86ebe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	902d0413a229cd6f0d4d0cd18f47f680be9b1c51dede64b7e44b0e89ca82109d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e104d688997769a4c8fb350cc7d87b2fc94620f7664446a1ec3648ab3cc86ebe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

15 MINUTA ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

5 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

10 ORE ME PARE

Rrëzohet kërkesa e PD që të mos votohet drafti për pagat e magistratëve, Balla: Hipokrizi! Bardhi: Tërhiqeni ligjin

10 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

Politike

Bardhi: Kompania që u kap me 41 kilogramë kokainë, përfitojë nga Qeveria 1 milion euro nga fondet e IPARD

Sipas tij, ky rast tregon dështimin e qeverisë në kontrollin dhe administrimin e fondeve që synojnë mbështetjen e ekonomisë dhe bujqësisë.



17 Shtator 2026, 20:17
Nga E. D



Gazment Bardhi

TIRANË- Kreu i Grupit Parlamentar të PD, Gazment Bardhi ka denoncuar një skandal gjatë fjalës së tij në seancën plenare. Bardhi theksoi se kompania që u kap me 41 kilogramë kokainë, përfitojë nga qeveria 1 milion euro nga fondet e IPARD. Sipas tij, ky rast tregon dështimin e qeverisë në kontrollin dhe administrimin e fondeve që synojnë mbështetjen e ekonomisë dhe bujqësisë.

Në fund të deklaratës së tij, Bardhi tha se qeveria duhet të orientojë më shumë fonde drejt fermerëve dhe prodhuesve shqiptarë, ndërsa akuzoi mazhorancën se ka lejuar depërtimin e parave të krimit të organizuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Reagimi i Bardhit:

Nuk jeni mësuar të më dëgjoni të flas për ulla, sepse skandalet e kësaj qeverie i mbivendosen çdo ditë njëra-tjetrës, sa duket sikur jemi mësuar me të keqen dhe aktet si ky i sotmi, për të cilin kam kërkuar të flas, duken si të parëndësishme në krahasim me korrupsionin gjigand dhe copat e mëdha të pasurive kombëtare që ky pushtet grabit çdo ditë.

Por këtë marrëveshje e pashë si një rast të shkëlqyer për të treguar se si korrupsioni vret edhe ulla, se si krimi i organizuar ka hyrë në çdo qelizë të ekonomisë dhe se si kjo qeveri, në vend që të financojë fermerët e ndershëm dhe punëtorë, shpërndan paratë e taksapaguesve europianë tek trafikantët ndërkombëtarë të kokainës.

Dhe le ta nisim pikërisht nga ulla.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 19:07

"U përshëndetëm me shenjë
tonë sekrete"/ Djali i Kadri
Veseli rrëfen momentet para
dhe pas vendimit në Hagë:
Besojmë se Apeli do ta
korrigjojë vendimin

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 17:03

Dënimi ndaj ish-krerëve të
UÇK-së/ Protesta edhe në
SHBA, shqiptarët nga Times
Square këndojnë "Mora fjalë"
(VIDEO)

Ju sillni sot në Kuvend një marrëveshje ndërkombëtare që, ndër të tjera, flet për zhvillimin e sektorit, rritjen e konkurrencshmërisë, zgjerimin e tregtisë dhe promovimin e vajit të ullirit. Dhe kërkon që kjo marrëveshje të vazhdojë të jetë në fuqi.

Por çfarë vlere ka një marrëveshje që flet për nxitjen e sektorit të ullirit, kur qeveria shqiptare nuk nxit asgjë? Çfarë i duhet fermerit shqiptar një angazhim ndërkombëtar në letër, kur në tokën e tij nuk mbërrin as politika favorizuese, as mbështetja konkrete dhe as para?

Janë, të paktën, 100 mijë fermerë që merren me ullirin në Shqipëri. Njëqind mijë familje që mbjellin, punojnë dhe prodhojnë, por për ta nuk ka një skemë kombëtare të dedikuar për ullirin. Nuk ka subvencion të drejtpërdrejtë të dedikuar, sepse vetëm për 5 muaj qeveria i ka dhënë mikut të Kryeministrit 34 milionë euro për të prodhuar armatime që nuk ekzistojnë.

Një raport i majit të këtij viti ngre shqetësime serioze të fermerëve dhe prodhuesve të vajit të ullirit për kosto të larta dhe zero mbështetje. Jo se qeveria nuk ka lekë. Shqiptarët paguajnë taksa të larta, por ne vidhemi në mënyrë të harbur dhe të pafre nga qeveria.

Një qeveri që ka interes zhvillimin e bujqësisë dhe të prodhimit, që ka interes rritjen e fitimit dhe jo të kostove, ka mundësinë të zbatojë menjëherë frymën e marrëveshjes për ullirin.

Mjafton pak vullnet i mirë për t'u shërbyer vërtet njerëzve punëtorë dhe qeveria mund ta shpallë ullirin prioritet kombëtar dhe strategjik për pesë vjet.

Duket si kohë e largët tani, por gati 20 vjet më parë, Kryeministri Berisha pati vizionin ta shpallte ullirin politikë kombëtare dhe subvencionoi mbjelljen e miliona rrënjëve ullinj.

Këtë kërkojnë sot fermerët dhe prodhuesit, këtë e mbështesin ekspertët dhe këtë politikë favorizuese zbatojnë që nga Italia, Franca, Greqia, deri tek Kroacia apo Mali i Zi, sa për të përmendur vetëm disa prej tyre me skema të posaçme të mbështetjes së sektorit.

Kudo mbështet prodhimi i ullirit dhe i vajit të ullirit, përveç Shqipërisë!
Qeveria mund të heqë TVSH-në për inputet bujqësore, mund të ulë taksat mbi përpunimin.

Qeveria ka të gjithë instrumentet për t'i dhënë fermerit mundësinë të prodhojë ullinj me kosto më të ulët dhe fabrikës mundësinë ta shesë vajin shqiptar me një çmim konkurrues.

Të gjitha këto ju mund t'i bëni shumë thjesht, por ju nuk doni. Sepse prioriteti juaj nuk janë shqiptarët punëtorë, as në sektorin e ullirit dhe as në ndonjë sektor tjetër që nuk ju pasuron ju shpejt dhe nuk e shihni si mundësi për të pastruar paratë e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Po, po, e dëgjuat shumë mirë. Qeveria ka para, por ka zgjedhur të financojë me to Roni Jefetët e vet, Ergys Agasët e vet dhe trafikantët e kokainës. Madje këta i financon edhe me fondet e Bashkimit Europian.

Në këtë foton këtu është e dokumentuar një nga historitë më të mëdha propagandistike të suksesit rilindas me fondet e Bashkimit Europian për zhvillimin e bujqësisë, me fondet e IPARD-it të famshëm, akoma i bllokuar për shkak të korrupsionit madhor me administrimin e tyre.

Skeda e shkurtër e kompanisë është kjo:

- (AMG Food), e krijuar në 2019-ën.
- Deklarohet si përfutuese nga fondet IPARD në 2021-shin.
- Me letra del se financimin e ka marrë në 2023-shin.
- Granti, pra fondi dhuratë nga paratë e takapaguesve europianë të programit IPARD: rreth 1 milionë euro.
- Sponsor publik që në vitin 2021 : kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.
- Në vitin 2021 Edi Rama shkoi personalisht për ta promovuar kompaninë si një prej investimeve të financuara nga IPARD-i, që do të rriste sigurinë ushqimore, standardet e prodhimit dhe mundësinë për të eksportuar në tregun europian.
- Në mars 2025, për ta shtuar në skedën e kompanisë, zbulohet hedhja në tregun shqiptar e 8 tonëve mish pule me salmonelë.
- Në shtator 2026, në skedën e kompanisë u përfshiedhe trafiku i kokainës.

Pra, me sponsor publik Kryeministrin e Shqipërisë, qeveria financoi me taksat e qytetarëve të bashkimit europian, një biznes, i cili, bashkë me pulat e ngrira nga Brazili, solli në Shqipëri, tre ditë më parë, edhe 41 kilogramë kokainë.

Pse them sponsor publik për kryeministrin?

Këto foto janë nxjerrë nga një aktivitet i tij publik në vitin 2021, kur propagandonte se fondet e IPARD-it po ndihmonin fermerët, bujqësinë, agro-përpunimin, industrinë lehtë ushqimore.

Dërshak të nunës carinza të policisë halna kundër krimin të nrganizuar dhe rriatava të trafikut ndërkombëtar

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:46

“Urime për look-un e ri”/ Muçi ironizon deputeten socialiste, Zegjine Çaushti i përgjigjet ashpër: O psikopat, na hape barkun

më të klikuarat

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente fals/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallat në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete



VIDEO e rëndë, familjarët i afrohen shoferit dhe... çastet tronditëse të aksidentimit fatal të kalimtarit

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

...në emër të parës sënderë të parës sënderë... nga ministri i organizuar dhe ngjashëm të kësaj natyre... të drogës me rrënjë në Shqipëri, ne sot dimë që kompania e promovuar nga kryeministri dhe e financuar me 1 milionëeuro nga taksat e qytetarëve europianë, është kapur duke sjellë në Shqipëri 41 kilogramë kokainë. Çfarë mund të tëduhet për sponsorizim më shumë sesa prania e kryeministrit në biznes?

Ja ku e keni sot historinë tuaj të suksesit, jo vetëm tëmënyrës abuzive me fondet e IPARD-it. Kjo është edhe pasqyra më besnike e mënyrës sesi në këto 13 vjet qeveria ka bërë gjithçka, ka hapur çdo derë, çdo dritare që të fuqizojë krimin, duke i ritur fuqitë ekonomike përmesbizneseve në dukje të ligjshëm dhe të pastër.

Ne kemi parë nga hetimet zyrtare të këtyre viteve të fundit, sesi trafikantët e drogës pastrojnë para në sektorin e ndërtimit me lejet e dhëna nga Edi Rama, tani po shohim sesi paratë e drogës janë futur në çdo sektor tëekonomisë me nevojën akute të pastrimit të qindra milionëeurove çdo vit./Dosja.al

gazment bardhi

Sondazh

Poll

Politike

17 Shtator 2026, 19:51

“Ne nga fshati jemi akoma te parmenda, ju po na çoni te Inteligjenca artificiale”/ Korreshi ironizon qeverinë: E nisët me Diellën, morët ca lekë

Saimir Korreshi TIRANË- Deputeti i Partisë Demokratike Saimir Korreshi, ka ironizuar në Kuvend qasjen e qeverisë ndaj inteligjenc&...

"Më ngjanin me pionerët e Enverit"/ U përplas me protestuesit, Luarasi: Në 730 komente kërkohej pushkatimi ose varja në litar

Politike

17 Shtator 2026, 19:30



Tensione në Kuvend/ Balla- Muçit: E ke ndarë mandatin përgjysmë me Qorin. Deputeti i Lëvizjes Bashkë: Kuvendi të njohë gjenocidin serb në Kosovë

Politike

17 Shtator 2026, 19:10

"U përshëndetëm me shenjën tonë sekrete"/ Djali i Kadri Veselit rrëfen momentet para dhe pas vendimit në Hagë: Besojmë se Apeli do ta korrigjojë vendimin

Politike

17 Shtator 2026, 19:07

Kurti takim me kreun e PDK pas verdiktit të Hagës: Vendimi ndaj krerëve të UÇK-së është i padrejtë, duhet të përmbysset në Apel

Politike

17 Shtator 2026, 18:48

Politike

17 Shtator 2026, 18:10

Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg/ Reagon Thaçi: Mirënjohje popullit të Kosovës për mbështetjen, do ta apelojmë vendimin e Hagës

Hashim Thaçi HAGË- Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar një ditë pasi Gjykata Speciale në Hagë...

"E lexoni historinë me porositë e Kryeministrit"/ Gjekmarkaj: Berisha, i vetmi personalitet që nuk bëri kompromis për çështjen e territoreve

Politike

17 Shtator 2026, 16:40

Aeroporti i Vlorës/ MIE: Arbitrazhi i Emergjencës rrëzon kërkesat kryesore të VIA-s! Nuk pranon të pezullojë zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit

Politike

17 Shtator 2026, 16:36

"Historia e Kosovës nuk fillon në Hagë dhe..."/ Igli Hasani: Me deklaratën e thamë qartë që do qëndrojmë pranë

Kosovës

Politike

17 Shtator 2026, 16:30



Balla akuzon Berishën: Takove rusin që hartoi raportin kundër UÇK-së, punove kundër Hashim Thaçit(VIDEO)

Politike

17 Shtator 2026, 16:17

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.